

RAPORTI I LIKUIDATORIT TE EMERUAR

Mbi Pasqyrat Financiare per qellim te likuidimit te shoqerise:

«Cable Albania Elbasan Suth» Shpk

Per periudhen e mbyllur me
31 dhjetor 2016

Raport i Likuidatorit
Per likuidimin perfundimtar te shoqerise «Cable Albania Elbasan Suth » sh.p.k.**Drejtuar : Zotit Leonard Prifti**
(Administrator i shoqerise)**ELBASAN**

Shoqeria „Cable Albania Elbasan Suth“ shpk eshte krijuar ne daten 26.02.2009 dhe eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me NIPT K92703204L.

Ajo eshte regjistruar prane organeve tatimore Elbasan. Aktiviteti kryesor i saj eshte Transmetim i programeve radiotelevizive ne kabell.

Me vendimin e asamblese se ortakeve, date 15.11.2016 me objekt fillimin e procedurave te likuidimit te shoqerise, jam emeruar si likuidator dhe mu kerkua te kryej procedurat e likuidimit te shoqerise „Cable Albania Elbasan Suth“ sh.p.k.

Procedurat e likuidimit si dhe pasqyrat financiare te likuidimit te shoqerise jane bere, duke pasur parasysh realizimin e ketyre qellimeve:

1. Te realizohet shitja e aktiveve.
2. Te arketohen kerkesat per arketim dhe te drejta te tjera te shoqerise nga te tretet.
3. Te behet shlyerja e plote e detyrimeve ndaj te treteve.
4. Aktivet neto, mbas shlyerjes se detyrimeve tu shperndahen drejt ortakeve te shoqerise.
5. Rezultati i likuidimit te paraqitet ne menyre te besueshem dhe te sinqerte.

Ne perfundim ju relatojme juve se procedurat e siperpermendura i kemi realizuar ne kete menyre:

1. Shitja e aktiveve
Sipas bilancit te marrjes ne dorezim per fillimin e procedurave te likuidimit shoqeria nuk kishte ne pronesi te saj aktive per tu shitur.
2. Arketimi i kerkesave per arketim nga te tretet
Sipas bilancit te marrjes ne dorezim per fillimin e procedurave te likuidimit shoqeria nuk kishte kerkesa te arketueshme nga te tretet.
3. Shlyerja e detyrimeve ndaj te treteve
Sipas bilancit te marrjes ne dorezim per fillimin e procedurave te likuidimit shoqeria nuk kishte detyrime ndaj paleve te treta.
4. Shperndarja e aktiveve neto
Ortaku i vetem terhoqi fitimet e akumuluar dhe kapitalin e nenshkruar.

5. Perpilimi i pasqyrave financiare te likuidimit perfundimtar.

Ne perfundim u hartuan pasqyrat financiare te likuidimit perfundimtar te shoqerise dhe ju paraqiten ortakeve per ti aprovuar. Procedurat e likuidimit kane qene transparente, te sinqerta e te besueshme. Pasqyrat financiare te likuidimit jane hartuar konform rregullave dhe normave kontabile te parashikuara nga Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Ne besojme se qellimi i misionit te marre persiper u realizua ne te gjitha keto pika ne daten 31 Dhjetor 2016.

Me aprovimin e ketij raporti ortaket vec te tjerash kane aprovuar:

1. Detyrimin e tij per te mbuluar detyrimet eventuale qe mund te dalin ne te ardhmen, te cilat nuk ishin te evidentuara ne bilancin e likuidimit, ose per te cilat nuk pati kerkesa nga kreditoret gjate periudhes se likuidimit, sic mund te jene detyrime per tatime dhe taksa qofte nga organet tatimore apo lokale.
2. Aprovimin e dorheqjes se likuidatorit Agim Qenani qe nga ky moment, dhe nese procesi i likuidimit bllokohet per mosshlyerje detyrimesh prej tij, ortaku i vetem duhet te caktoje nje likuidator tjeter, ose ne te kundert shoqeria kthehet nga shoqeri ne likuidim e siper ne nje shoqeri me aktivitet normal ku ortaku merr drejtimin e shoqerise si administrator.

Likuidatori
Agim Qenani



Hartuar ne Elbasan me 15.03.2017